



DEGA NË LIPJAN-OGRANAK LIPLJANE

P.nr.43/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale, ndaj të pandehurve A. J. dhe H. J., të dy nga Lipjan në rr.”B. G.”, të cilët i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.nr.879/16 të dt.19.01.2017, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.12.04.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Sh. B., dhe të pandehurve, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve:

1.A. J., i biri i O. dhe E., e gjinisë R. i lindur me *data e lindjes...*, në Lipjan, me vendbanim në rrugën “B. G.”, në Lipjan, i martuar, me profesion bujk, i gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.H. J., i biri i O. dhe E., e gjinisë R. i lindur me *data e lindjes...*, në Lipjan, me vendbanim në rrugën “B. G.”, në Lipjan, i martuar, me profesion bujk, i gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datën 01.02.2016, rreth orës 10:00^h, në fshatin K., Komuna Lipjan, në tregun e kafshëve, i dëmtuari S. K. kishte shkuar për të blerë lope ishte takuar me të pandehurit vëllezrit A. dhe H. J., të cilët kishin filluar i thonin se “ku je ti more që neve po na shanë”, me këtë rast A. e kishte goditur me e grushta në fytyrë kurse vëllai tjetër H. J. e kishte goditur me shkop në këmbën e majtë të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me dëmtime të përkohshme për shëndetin,-

-me këtë secili veç e veç kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Andaj gjykata në baze të neneve, 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73, 188 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit i gjykon me,

DËNIM ME GJOBË

1.Të pandehurin **A. J.** e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 150-€ (njëqindëpesëdhjetëeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë konform nenit 46 par 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgimi do ti llogaritet shuma prej 20-€.

2.Të pandehurin **H. J.** e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 150-€ (njëqindëpesëdhjetëeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë konform nenit 46 par 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgimi do ti llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari S. K. nga fshati H. i V. K.Lipjan, udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt civile gjyqësore.

DETYROHEN të akuzuarit që në mënyrë solidare, në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë shumën prej 20-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën secili veç e veç nga 20- €, si dhe shumën prej 30.-€, në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj, PP.II.nr.879/16 të dt.19.01.2017, i ka akuzuar të pandehurit Arben Jashanica dhe Hysen Jashanica, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe ti dënoi sipas ligjit.

I pandehuri A. J. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, respektivisht për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtë ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase i njëjti është mbatës i familjes, dhe njëherit kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

Gjithashtu i pandehuri H. J. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, respektivisht për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtë ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase i njëjti është mbajtës i familjes, dhe i njëjti e mban familjen me të ardhura bujqësore, dhe njëherit kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehurve, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurit të cilat ndikojnë në zgjedhjen dhe llojin e lartësisë së dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se

të pandehurit janë mbajtës të familjes, të gjendjes jo të mirë ekonomike, sinqeritetin e të pandehurve gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtëve iu shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së, Vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompensimit të Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 43/17, dt. 12.04.2018

Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.